



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.4/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Dr.sc. Rafet Haxhaj kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me apelet e parashtruar nga Arif Butuç kryetar i subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP) me seli në Mamushë, si dhe Zymer Zogaj kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP) kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) lidhur me mos certifikimin e kandidatit për deputet Zymer Zogaj, në seancën e panelit të mbajtur me 26.05.2017, mori këtë:

V E N D I M

Hudhen si të palejuara apelet, Anr.4/2017 i subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP) dhe Anr.5/2017 i kandidatit për deputet Zymer Zogaj të datës 25.05.2017.

A r s y e t i m

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajton si një ankesë për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, me datën 25.05.2017, ka pranuar dy apele Anr.4/2017 dhe Anr.5/2014, të paraqitur nga Arif Butuç kryetar i subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP) me seli në Mamushë dhe Zymer Zogaj kandidat për deputet nga subjekti politik KTAP, me të cilën pretendohet se KQZ nuk ka certifikuar kandidatin me numër rendor 4, Zymer Zogajn nga radhët e subjektit politik KTAP.

Parashtruesit e apeleve si në apelet e parashtruar në PZAP, ashtu edhe në seancën dëgjimore, kanë theksuar se KQZ me vendimin Nr.691/2017 i datës 24.05.2017, nuk e ka certifikuar kandidatin me numër rendor 4, Zymer Zogaj me arsyetimin se i njëjti është nga komuniteti shqiptar dhe jo turk, gjë e cila sipas parashtruesit të apelit bie ndesh me kushtetutën dhe ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës, si dhe me pretendimet se KQZ-së, ka regjistruar kandidat të përkatësive tjera subjekteve tjera politike të cilat nuk i përkasin komunitetit jo shumicë. I kanë propozuar PZAP-së, që apelet të aprovohen dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

PZAP-i, pas pranimit të apelit në kuptim të nenit 11 paragrafi 7 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e ka informuar KQZ-në dhe ka kërkuar që deri më datë 25.05.2017 në orën 12:00 të përgjigjet lidhur me apelin e parashtruar.

Në përgjigjen e ofruar nga KQZ-ja dhe në seancën e mbajtur dëgjimore, kanë theksuar se KQZ-ja, në këtë rast ka vepruar konform nenit 64 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në harmoni me nenin 111

par1 të LZP-së, duke mos e certifikuar një kandidat për deputet të subjektit politik KTAP, pasi që është verifikuar se i njëjti nuk është i komunitetit turk por i njëjti është shqiptar, KTAP në zgjedhjet e 11.06.2017, garon për vendet e rezervuara respektivisht të garantuara për kuvendin e Kosovës andaj përfshirja e komunitetit jo turk në listën e kandidatëve për deputetë bie në kundërshtim me dispozitat e lart theksuar ligjore. Me propozim për PZAP, që apelet e parashtruar të refuzohen si të pa bazuara.

Paneli pasi që shqyrtoi dhe analizoi pretendimet e palëve të parashtruar në seancën dëgjimore dhe pasi ka bërë analizimin e shkresave të lëndës gjeti se:

Apelet janë të palejuara

Paneli i ka vlerësuar apelin e parashtruar dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 10 të Rregullës Nr. 02/2015- Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, se pala parashtruese e apelit ka të drejtën e parashtrimit të apelit dhe se PZAP-i ka kompetencën e shqyrtimit të apeleve dhe të nxjerrë vendime për apelimet e tilla.

Paneli vlerëson se pretendimet ankimore të parashtruesve të apeleve se me rastin e marrjes së vendimit nga KQZ-ja për certifikimin e listës së kandidatëve për deputet nga subjekti politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP) u është bërë e padrejtë lidhur me mos certifikimin e kandidatëve të saj për deputet nuk qëndrojnë, pasi që heqja e kandidatëve është bërë para se të bëhet certifikimi i listës së kandidatëve. Paneli ka gjetur se me vendimin e atakuar të KQZ-së nr. 691/ 2017 të dt. 24.05.2017, nuk është refuzuar asnjë kandidat për deputet nga radhët e subjekti politik KTAP, dhe cila gjë do të mund të ishte objekt i shqyrtimit nga ana e panelit.

Mbi këtë bazë Paneli vlerëson se apelet e paraqitura ndaj vendimit të KQZ-së Nr.691/2017 i datës 24.05.2017, për certifikimin e kandidatëve për deputet nga radhët e subjektit politik KTAP janë të palejuara.

Prandaj nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 118 par.1 të LZP-së, si dhe nenit 11 par.5 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 4/2017 më datën 26.05.2017.

Kryesuesi i Panelit
Dr. Sc. Rafet Hazhaji

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.

